



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i procedurës: “Blerje aparate telefonik”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 32332200-1/ 32429000-6/
32552140-0.

Në bazë të nenit 21 pika 2, nenit 40 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2 pika 2/c, nenit 46 pika 2/g, nenit 56 dhe nenit 78 pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, duke i vlerësuar të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e procedurës. Përkatësisht, si vijon:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1.	Telefona Analog	copë	16
2.	Telefon Dixhital	copë	8
3.	Telefona mobile	copë	2
4.	Telefona Post Operator	copë	2
5.	Kartë dixhitale për centralin ekzistues	copë	1

Specifikimet teknike si më poshtë vijon:

1. Telefona Analog

- Lloji i telefonit: me kabllo
- Materiali: Plastike
- Ngjyra: e zezë

- Lloji i telefonuesit: tastiera e vetme
- Lloji i Sistemit të Përgjigjeve: Dixhital
- Operacioni me shumë linjë: Operacioni me një linjë
- Telefonues me një prekje me butona memorie
- Telefon me kablo me një linjë për montim në tavolinë ose në mur
- ID-ja e telefonuesit e pajtueshme me memorien me 50 stacione
- Libri telefonik me 50 stacione dhe 20 numra të ri-telefonuar
- ID e telefonuesit/Telefonata në pritje - Celulari shfaq numrin, orën dhe datën. 28 grupe memorie thirrjesh hyrëse; 5 grupe memorie të thirrjeve dalëse; 2 grupe memorie të telefonimit të shpejtë me 1 prekje.
- Vëllimi i ziles së programueshme me 4 hapa i rregullueshëm; melodi me 8 zile e përzgjedhur; Cilësimet e orës së alarmit me 3 programe përfshin funksionet e ekranit të ID-së së telefonuesit, altoparantit, regjistrimit të numrit të telefonit, ziljes së lartë/të ulët të rregullueshme,

2. Telefon Dixhital

- Ekran LCD: Ofron informacione të qarta për thirrjet dhe opsionet.
- Butona të dedikuara për linja: Mban disa linja aktive njëkohësisht.
- Funksionaliteti i altoparantit: Për thirrje pa përdorur duart.
- Porta për kufje: Mundësia e përdorimit të kufjeve për thirrje private.
- Menaxhim i thirrjeve: Mundësi për transferim, mbajtje dhe konferenca.
- Peshë: 790g
- Përmasat: 220x175x133mm.
- Të përshtatshëm për sistemin aktual Alcatel Lucent OmniPCX Office Large System.

3. Telefona mobile

- Ekran Super AMOLED, 120Hz, 6.6 inç, 1080 x 2340 piksel
- Sistemi Operativ Android 14, One UI 6.1
- CPU- Octa-core (4x2.4 GHz Cortex-A78 & 4x2.0 GHz Cortex-A55)
- GPU-Mali-G68 MP5
- NETWORK- GSM / HSPA / LTE / 5G
- Karta SIM- Single SIM (Nano-SIM, eSIM) or Hybrid Dual SIM
- Memoria -128GB 4GB RAM, 128GB 6GB RAM, 128GB 8GB RAM, microSDXC
- Kamera Kryesore-50 MP (f/1.8, wide), 8 MP, (f/2.2, ultrawide), 5 MP (f/2.4 macro)
- Kamera e Përparme- 13 MP, f/2.2, (wide)
- Bateria - Li-Po 5000 mAh
- Bluetooth -5.3, A2DP, LE
- Wi-Fi- Wi-Fi 802.11 a/b/g/n/ac/6, dual-band, Wi-Fi Direct
- GPS -GPS, GLONASS, GALILEO, BDS, QZSS
- USB-USB Type-C 2.0

4. Telefona Post operator

- Ekran LCD: Ofron informacion të detajuar përsa i përket thirrjeve/mesazheve.
- Thirrje "Hands Free".
- Butona të programueshme (për kontakte të shpeshtë).
- Integrim me sistemin e mesazheve zanore (Menaxhim i mesazheve zanore).
- Navigim i thjeshtë i telefonit nëpërmjet butonave të navigimit.

- Dritë njoftuese LED (Për thirrjet e humbura/mesazhet zanore).
- Menaxhimi i shumë linjave: Mundësia për të trajtuar disa linja njëkohësisht, duke e bërë ideal për zyrat me volum të lartë thirrjesh.
- Tastierë QWERTY alphanumeric
- Pesha: Rreth 1 kg.
- Përmasat: 240x175x133mm.
- Të përshtatshëm për sistemin aktual Alcatel Lucent OmniPCX Office Large System.

5. Kartë dixhitale për centralin ekzistues

- Digital Interface UAI-16 Board e cila është një modul ndërfaqe dixhitale Alcatel Lucent me 16 porta dixhitale shtesë dhe i projektuar posaçërisht për të punuar me saktësi me sistemin aktual Alcatel Lucent OmniPCX Office Large System.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), në pikën 9.2 të Udhëzimit të Agjensisë së Prokurimit Publik Nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Kritere:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në objektin e ushtrimit të veprimtarisë së tij edhe objektin që po prokurohet (autoriteti kontraktor do të verifikojë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit nëse e ka objekt të ushtrimit të veprimtarisë së tij). Nëse pas verifikimeve rezulton se, ndonjë nga operatorët ekonomik nuk ka si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, oferta e tyre do të refuzohet automatikisht nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), në pikën 15, germa a), të Udhëzimit të Agjensisë së Prokurimit Publik Nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë formularin e ofertës në të cilën do të përcaktohen çmimi për çdo zë dhe çmimi në total për artikujt e kërkuar, vendodhja e saktë e subjektit, pika e kontaktit të operatorit ekonomik (emër mbiemër, nr.cel, adresë email).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), në pikën 9.2 të Udhëzimit të Agjensisë së Prokurimit Publik Nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuar të autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 3, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), në pikën 9.2 të Udhëzimit të Agjensisë së Prokurimit Publik Nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

4.Operatori ekonomik pjesmarrës i shpallur fitues në SPE, në datën dhe orën e paraqitjes pranë Autoritetit Kontraktor sëbashku me dokumentacionin e kërkuar në këtë ftesë për ofertë, duhet të paraqesë edhe një mostër të mallit të ofertuar prej tij.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 40 pika 6/a e VKM Nr. 285/2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit”, me ndryshime, ku shprehimisht thuhet se: *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. 38 Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

Mosparaqitja e mostrës, është kusht skualifikues.

***Shënim:**

1. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e refuzimit dhe kthimit të mallit në rast se konstaton se nuk përputhet me specifikimet e kërkuara nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël dhe do të vijohet me njoftimin e operatorit ekonomik vijues.
2. Autoriteti Kontraktor do të s’kualifikojë operatorin ekonomik ofertues edhe pse me ofertën e vlerësuar të rregullt dhe me çmimin më të ulët, nëse nuk respekton afatin e paraqitjes pranë Autoritetit Kontraktor.
3. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël do të refuzoj automatikisht ofertën e paraqitur nga një operator ekonomik, i cili në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluar nga ky autoritet brenda periudhës një vjeçare nga data e zhvillimit të kësaj procedure, nuk është paraqitur brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë për të realizuar objektin e prokurimit, pavarësisht faktit se mund të ketë njoftuar autoritetin kontraktor, por nuk ka dhënë arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit. Ofertat e refuzuara nuk do të përfshihen në klasifikimin e ofertave.
4. komisioni i prokurimit me vlerë të vogël do të refuzoj automatikisht operatorët ekonomik, oferta e të cilëve është ulur më shumë se 50% e fondit limit të përllogaritur. Ofertat e refuzuara nuk do të përfshihen në klasifikimin e ofertave.
5. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Afati i dorëzimit të mallit do të jetë brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), në pikën 15 dhe 16 të Udhëzimit të Agjensisë së Prokurimit Publik Nr. 5, datë 25.06.2021, ”Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Kërkesat e mësipërme janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke shërbyer për autoritetin kontraktor për njohjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.